

ËSHTË KOHA PËR LIGJ PËR LOBIM NË KOSOVË

QERSHOR, 2021



ËSHTË KOHA PËR LIGJ PËR LOBIM NË KOSOVË

COPYRIGHT © 2021.

Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit apo bartjes në asnjë formë, duke përfshirë edhe fotokopjimin apo sistem tjetër të ruajtjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim.

Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jokomerciale. Cilido që ka për qëllim të përdorë fragmente ose materiale të ndryshme të këtij publikimi, është i detyruar ta tregojë qartë burimin sa herë që janë nxjerrë fragmentet ose materialet e përdorura.

Nëse keni ndonjë koment, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes ndonjë prej opsioneve të mëposhtme:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Autor: KDI

Dizajn dhe faqasje: Envinion

Ky publikim është përgatitur nga Instituti Demokratik i Kosovës – Transparency International Kosova dhe përkrahur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Hulumtimi është pjesë e Programit “Frenimi i korrupsionit përmes ngritjes së transparencës, gjithpërfshirjes dhe llogaridhënies gjatë procesit legjislativ në Kosovë”.

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS-it.

PËRMBAJTJA

HYRJE	6
ÇKA ËSHTË LOBIMI?	7
PËRPARËSITË DHE SFIDAT E RREGULLIMIT LIGJOR TË LOBIMIT	8
RREGULLIMI LIGJOR I LOBIMIT	9
HISTORIK I SHKURTËR I RREGULLIMIT LIGJOR TË LOBIMIT NË INSTITUCIONET E BE-SË	10
RREGULLIMI I LOBIMIT NË DISA SHTETE ANËTARE TË BE-SË	11
PRAKTIKAT E SHTETEVE FQINJE	18
REKOMANDIMET	20



HYRJJE

Viteve të fundit, Këshilli i Evropës dhe shumë organizata që punojnë në promovimin dhe ruajtjen e vlerave të shoqërisë demokratike po ndjekin nga afër zhvillimet në shtetet demokratike dhe ndryshimet shoqërore që po sjellin ato. Njëri nga shqetësimet kryesore në raportet e tyre është edhe ai për rënien e interesimit të qytetarëve për përfshirje në procese politike si dhe zbehjen e besimit të qytetarëve në institucione. Shkaktar i një gjendje të tillë po konsiderohet edhe rritja e ndikimit të grupeve të interesit mbi institucionet “tradicionale” shtetërore (parlamentin, qeverinë dhe institucionet lokale). Sipas Këshillit të Evropës, vetëm në Bruksel sot veprojnë mbi 15,000 grupe të interesit, prej të cilave 2,600 grupe i kanë hapur edhe zyrat e përhershme në kryeqytetin evropian me qëllim të lobimit gjatë vendimmarrjes në institucionet e Bashkimit Evropian¹.

Edhe në Kosovë, disa studime të fundit flasin për ndikimin që po ushtrojnë grupet e ndryshme të interesit në vendimmarrjen brenda institucioneve shtetërore. Në këto studime janë evidentuar raste të dyshimta të përpilimit të legjislacionit për interesa të individëve apo grupeve të caktuara. Rasti i Udhëzimit Administrativ për Homologimin e automjeteve konsiderohet si rast eklatant i “legalizimit” të monopolit për një kompani që ofron këtë shërbim. Ligji i ri për Noterinë është një tjetër shembull i fenomenit të *legjislacionit të porositur*² në Kosovën e pasluftës³. Ushtrimi i ndikimit

të aktorëve jashtëinstitucionalë po vërehet si në Legjislativ ashtu edhe në Ekzekutiv dhe në të dy nivelet e pushtetit, atë qëndror dhe lokal.

Studiuesit pajtohen se përpjekjet e aktorëve “jashtë-institucionalë” për të ndikuar në vendimmarrjen politike nuk duhet të nënvlerësohen. Përderisa ndikimi i tyre në politikë nuk është dukuri e re, shkalla e përhapjes dhe vizibiliteti i tyre është rritur ndjeshëm viteve të fundit, sidomos me përhapjen e teknologjisë së informacionit dhe formave të reja të komunikimit.

Me qëllim të forcimit të besimit të publikut te institucionet qeverisëse, vendimmarrja në të gjitha fazat e saj (duke përfshirë edhe fazën e konsultimeve publike) duhet të jetë sa më transparente. Qytetarëve duhet t’u njihet e drejta të informohen rreth aktorëve që kanë qasje dhe ushtrojnë ndikim mbi vendimmarrjen qeveritare. Përndryshe, nëse format e ushtrimit të ndikimit kryhen në mungesë të transparencës dhe llogaridhënies së plotë, ato nxisin dyshime te publiku dhe dëmtojnë demokracinë.

Ky studim i shkurtër ka pasur për synim t’u përgjigjet tre pyetjeve në vijim:

- 1 Sa është shkalla e përfshirjes së akterëve jashtë-institucionale në procese politike?
- 2 Cili është ndikimi i tyre në funksionimin e institucioneve demokratike dhe legjitimitetin e procesit politik?
- 3 Çfare kornize ligjore për rregullimin e lobimit i duhet Kosovës?

1 Lobbying in a democratic society (European code of good conduct on lobbying) <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=17832&lang=en>

2 Instituti Demokratik i Kosovës “Legjislacioni i porositur” <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2019/12/92-Raport-i-Legjislacioni-i-porositur-ALB-02.pdf>

3 UNDP Corruption Risk Assessment for the Chamber of Notaries https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/risk-assessment-for-the-kosovo-chamber-of-notaries.html





Qëllimi kryesor i këtij punimi ka qenë të nxisë debat publik në shoqërinë kosovare rreth rolit të aktorëve të ndryshëm jashtëinstitucionalë në vendimmarje dhe të bëj një vlerësim preliminar të nevojës për rregullim ligjor të tij. Punimi gjithashtu përshkruan disa prej sistemeve ekzistuese të rregullimit ligjor të lobimit në Evropë dhe paraqet një analizë të shkurtër të mundësive dhe sfidave që aktivitetet lobiste paraqesin për funksionimin e institucioneve demokratike. Edhe pse është analizuar edhe modeli amerikan i rregullimit të lobimit ai është lënë qëllimisht jashtë këtij punimi dhe duke mbajtur fokusin te modelet e shteteve evropiane.

Çka është lobimi?

"lobimi është çdo komunikim (me gojë ose me shkrim) nga individë apo grupe të interesit me një zyrtar publik për të ndikuar në ligjvënien, politikëbërjen apo vendimmarjen."

Një përkufizim më i gjërë i termit *lobim* e definon atë si komunikim (me gojë ose me shkrim) nga individë apo grupe të interesit me një zyrtar publik për të ndikuar në ligjvënien, politikëbërjen apo vendimmarjen. Për të bërë dallimin mes *lobimit tradicional* dhe *aktiviteteve avokuese* si pjesë integrale e proceseve në demokracitë përfaqësuese duhet dhënë edhe dy sqarime shtesë:

(1) Lobimi ushtrohet nga aktorë jashtë-institucionalë, me fjalë tjera individ apo grupe të interesit të cilët, duke vepruar kështu, nuk ushtrojnë apo nuk përmbushin ndonjë mandat kushtetues apo post publik (nëse kanë një të tillë).

(2) Lobistët, duke ushtruar ndikim në vendimmarjen politike, përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për shërbimet e tyre. Ky kriter synon të përjashtojë si formë lobimi aktivitetet avokuese⁴ si dhe peticionet e kërkesat e qytetarëve dhe shoqërisë civile drejtuar institucioneve për të diskutuar çështje me rëndësi për ta.

KUSH JANË AKTORËT JASHTË-INSTITUCIONALË?

Në shoqëritë moderne, ekziston një gamë e gjërë e aktorëve, që nuk burojnë nga proceset demokratike (zgjedhjet) dhe degët tradicionale të pushtetit, por që me veprimet e tyre ushtrojnë ndikim në institucione vendimmarjen brenda tyre.

Regjistri i Komisionit Evropian⁵ ka renditur kategoritë kryesore të aktorëve jashtë-institucionalë / grupeve të interesit / lobistëve si më poshtë:

- 1 Konsulentë profesionalë
- 2 Zyra juridike
- 3 Lobistë të korporatave të ndryshme
- 4 Shoqata profesionale
- 5 Sindikata
- 6 Organizata Jo-Qeveritare
- 7 Shtëpi mediatike
- 8 Institute hulumtuese (*think-tanks*),
- 9 Institucione akademike dhe
- 10 Përfaqësues të bashkësive fetare

LLOJET E AKTIVITETEVE LOBUESHE

Lobistët në përpjekjet e tyre për të ndikuar në vendimet politike përdorin forma të ndryshme të veprimeve si:

- Komunikimin e drejtpërdrejtë me politikanë dhe nëpunës civilë (brenda ose jashtë mjediseve institucionale);

4 Avokimi është veprim i palëve të interesuara të orientuara drejt qëllimit që zërat e tyre të dëgjohen për çështjet që ndikojnë në jetën e tyre dhe të tjerëve. Shumica e organizatave jofitimprurëse përdorin avokimin për arrihtjen qëllimeve të tyre.

5 EU Transparency Register <https://ec.europa.eu/transparencyregister/public/homePage.do?redir=false&locale=en>





- Ofrimin e këshillave profesionale dhe prezantimeve për çështje me interes;
- Përpilimin dhe shpërndarjen e draft-raporteve gjatë procesit të hartimit të politikave apo akteve ligjore;
- Mbajtjen e kontakteve jo-formale me vendimmarrës, përmes letrave, postës elektronike, bisedave telefonike etj.
- Pjesëmarrjen në seanca dëgjimore si në komisione parlamentare po ashtu edhe në grupet punuese qeveritare gjatë fazës së konsultimeve publike;

PËRPARËSITË DHE SFIDAT E RREGULLIMIT LIGJOR TË LOBIMIT

Lobimi i rregulluar me ligj e përmirëson sistemin demokratik të një vendi duke kontribuar në:

- Ngritjen e pluralizmit dhe shumëllojshmërisë së ideve dhe zgjidhjeve për çështje të caktuara.
- Sigurimin e informatave dhe ekspertizës së jashtme që shpeshherë mungon në institucione.
- Ngritjen e legjitimitet dhe besueshmërisë në vendimet e politikëbërësve
- Balancimin më të mirë të interesave të ndryshme individuale dhe grupore dhe
- Përmirësimin e përfaqësimit të grupeve të marginalizuara shoqërore.

Në anën tjetër, kritikët e përfshirjes së aktorëve jashtë-institucionalë në procese vendimmarrëse e konsiderojnë atë më shumë si praktikë të mirë qeverisjes demokratike sesa si përbërës të rëndësishëm të saj. Ata ngrisin shqetësime në lidhje me katër parimet themelore të demokracisë (përfaqësimin, legjitimitetin, transparencën dhe llogaridhënien) gjatë punës së tyre.

Sipas tyre qytetarët me votën e tyre të lirë janë elementi kryesor i proceseve demokratik dhe u takon votuesve të zgjedhin përfaqësuesit e tyre si dhe të sanksionojnë, me votat e tyre, politikanët e padëshiruar. Lobistët as nuk janë të zgjedhur

nga qytetarët dhe as të përzgjedhur përmes institucionit të konkursit publik andaj, pavarësisht ndikimit të tyre në procesin e vendimmarrjes dhe peshës ekonomike, nuk përfaqësojnë shoqërinë dhe as nuk mund të pretendojnë se përfaqësojnë interesat publike. Si të tillë atyre u mungon legjitimiteti dhe përfaqësimi.

Në anën tjetër, përderisa politikanët e zgjedhur janë përgjegjës për veprimet e tyre, lobistët nuk “kanë obligim” të japin llogari për veprimet e tyre para qytetarëve (përveç para punëdhënësve të tyre). Në sistemet politike pa rregullim ligjor për aktivitetet lobuese, parimi i llogaridhënies dobësohet edhe më shumë për shkak të mungesës së transparencës e cila ua pamundëson qytetarëve të njoftohen për takimet e lobistëve me politikanët e tyre dhe çështjet për të cilat lobohet.

Një problem tjetër paraqesin resurset e pabarabarta që i kanë këto në dispozicion grupet e ndryshme. Grupet e interesit me më shumë resurse për punësuar staf mbështetës, për të marrë me qira hapësira për punë pranë institucioneve ku ata llobojnë, për mbajtjen e konferencave ku shpjegojnë pozicionet e tyre janë në pozitë më të volitshme për të ushtruar presion më të madh dhe më të qëndrueshëm politik.

Praktika e *dyerve rrotulluese*⁶ rrit mundësinë për kompanitë private të aktivizojnë rrjetin e ish-bashkëpunëtorëve të tyre të veshur në petkun e politikëbërësit për interesat e tyre si dhe ngrisin shqetësime mbi integritetin e vendimeve që merren nga zyrtarët publikë që planifikojnë në të ardhmen punësim në sektorin privat. Këto praktika krijojnë situata të konfliktit të interesit dhe në shtetet pa rregullim ligjor të lobimit ato shumë lehtë mund të kalojnë kufinj të sjelljeve të pranueshme dhe “të evoluojnë” në akte të tjera të korrupsionit.

⁶ Nga anglishtja (revolving door), fenomen që përfshin rastet e rekrutimeve të lehta dhe të shpejta të individëve nga sektori privat në institucione publike dhe anasjelltas me qëllim të ofrimit të shërbimeve për grupet e ndryshme të interesit.





RREGULLIMI LIGJOR I LOBIMIT

Rregullimi ligjor i lobimit ka për qëllim të garantoj transparencë të plotë dhe llogaridhënie të aktiviteteve lobuese gjatë procesit të ligjvënies dhe politikëbërjes. Korniza ligjore për rregullimin e lobimit në shumicën e shteteve evropian përmban dispozita të cilat:

- 1 Obligojnë lobistët të regjistrohen zyrtarisht në Regjistrin e Lobuesve para se të fillojnë kontaktet e tyre me ndonjë prej zyrtarëve publikë.
- 2 Obligojnë lobistët që, gjatë procesit të regjistrimit, të ofrojnë informata edhe rreth institucionit publik në të cilin synojnë të lobojnë.
- 3 Obligojnë lobistët që të bëjnë publike shpenzimet e tyre dhe ato të punëdhënësit.
- 4 Obligojnë Autoritetin Mbikëqyrës të bëj Regjistrin e Lobuesve të disponueshëm për publikun me detajet rreth entiteteve të regjistruara.
- 5 Obligojnë Autoritetin Mbikëqyrës të sigurojë zbatimin e plotë të kornizës ligjore, të kryejë kontrollë të rregullta si dhe të sanksionojë lobistët e papërgjegjshëm.
- 6 Obligojnë Autoritetin Mbikëqyrës t'i raportojë Parlamentit në baza të rregullta rreth nivelit të zbatueshmërisë së ligjit dhe punës së tij si mekanizëm zbatues i tij.
- 7 U pamundësojnë ish-zyrtarëve publikë të rekrutohen nga organizatat lobiste menjëherë pasi të kenë lënë postet publik. Këto dispozita kundër *dyerve rrotulluese*, zakonisht rregullojnë *periudhën e ftohjes* (*cooling period*) si koha minimale para se ish-zyrtari të inkuadrohet në sektorin privat.

ZBATIMI I RREGULLORES SË LOBIMIT

Mekanizmi kryesor me të cilin mund sigurohet zbatimi dhe respektimi i ligjit është krijimi i një Autoriteti Mbikëqyrës. Shembuj të trupave të tillë gjenden në modelin amerikan (SHBA dhe Kanada), me resurse të mjaftueshme që garantojnë pavarësi nga ndërhyrjet politike. Me fjalë të tjera, megjithëse Autoriteti Mbikëqyrës raporton para Legjislativit, ky i fundit nuk mund të ndërhyjë në vendimmarrjen brenda Autoritetit. Një nivel të përafërt të pavarësisë gëzon edhe Komisioni Kryesor i Etikës Institucionale në Lituani, edhe pse me resurse të kufizuara në krahasim me ato të homologëve amerikanë.

Në disa shtete evropiane, mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Lobim lidhet me një ministri brenda qeverive të tyre. Për shembull, në Poloni, Ministria për Punë të Brendshme dhe Administratë mirëmban Regjistrin e Lobistëve, përderisa në Hungari mbikëqyrja kryhet nga Ministria e Drejtësisë.

Në shumë shtete evropiane, ushtrimi i kontrollit mbi lobistët është shumë më i butë, duke mos e kushtëzuar as qasjen në institucione me regjistrimin zyrtar. Për shembull, në Bundestagun gjerman edhe pse lobistëve që nuk ndodhen në Regjistrin e Lobuesve nuk ju lejohet qasja në kompleksin parlamentar ata mund të ftohen për të prezentuar para Komisioneve duke u mundësuar atyre kontaktin me komisionet parlamentare ose deputetët e Bundestagut.





HISTORIK I SHKURTËR I RREGULLIMIT LIGJOR TË LOBIMIT NË INSTITUCIONET E BE-SË⁷

Në vitin 1996 Parlamenti Evropian për herë të parë rregullon hyrjen e grupeve të interesit në ndërtuesën e tij me një sistem të veçantë kalimi. Secili lobist ishte i detyruar të regjistrohesh dhe të shpaloste detaje në lidhje me organizatën e tij dhe qëllimin e aktivitetit që kryente. Në anën tjetër, lobisti pranonte se do të respektonte Kodin e Sjelljes që përcaktonte standarde minimale etike.

Në vitin 2005 Siim Kallas, Komisioneri Evropian për Çështje Administrative, Auditim dhe Kundër Mashtrimit, lansoi Nismën Evropiane të Transparencës (ang. *European Transparency Initiative - ETI*) me synimin për të rritur besimin e publikut në institucionet e BE-së. Komisioni Evropian krijoi regjistrin e tij vullnetar për lobistët - **Regjistri i Përfaqësuesve të Interesit të Komisionit Evropian** në vitin 2008. Lobistët e regjistruar zotoheshin të respektonin Kodin e Sjelljes kurse “në këmbim” merrnin informata dhe njoftime të rëndësishme për propozimet që vinin në Komision Evropian. Në të njëjtin vit (2008) Parlamenti Evropian miratoi një Rezolutë mbi zhvillimin e një kornize ligjore për aktivitetet e përfaqësuesve të interesit në institucionet evropiane⁸. Grupi i përbashkët punues i Parlamentit dhe Komisionit Evropian filloi përgatitjen e **Marrëveshjen Ndër-Institucionale** (ang. *The Inter-Institutional Agreement - IIA*).

Marrëveshja Ndër-Institucionale u miratua në vitin 2011 me lansimin e **Regjistrin të Përbashkët të Transparencës** (ang. *the Joint Transparency Register - JTR*) një regjistër vullnetar i lobuesve. Lobistët tani mund të regjistrojnë aktivitetet e tyre në Sekretariatit dhe Regjistrin të Përbashkët të Transparencës (ang. *JTR Secretariat*) duke ofruar

informacione rreth aktivitetit, qëllimit të tij, resurseve dhe shpenzimeve. Sekretariati është një departament i ndarë nga Parlamenti dhe Komisioni Evropian e cili mund të vendosë për pezullime të përkohshme apo heqje të lobuesve nga Regjistri.

Në vitin 2014 Parlamenti dhe Komisioni Evropian nënshkruajnë një **Marrëveshje** të re Ndër-Institucionale që përmirëson rregullat për shpalosje financiare dhe disponueshmërinë e të dhënave. Parlamenti i bëri thirrje Komisionit Evropian të paraqesë një propozim të ri legjislativ para fundit të vitit 2016. Krye-komisioneri i atëhershëm Jean-Claude Juncker premtoi se do të rrisë transparencën në BE dhe në nëntor Komisioni Evropian miratoi një vendim i cilit kërkonte nga Drejtoritë e Përgjithshme të publikojnë datat, vendndodhjet, emrat dhe temat e diskutimit gjatë takimeve dy-palëshe, duke shtuar se mund të takojnë vetëm organizata dhe individë të vetë-punësuar që janë regjistruar paraprakisht në Regjistrin e Përbashkët të Transparencës.

Propozimi legjislativ i vitit 2014 parasheh krijimin e një regjistri të detyrueshëm për aktivitetin e lobistëve në Parlamentin Evropian, Komisionin Evropian dhe Këshillin Evropian. Propozimi gjithashtu synon t'i japë Sekretariatit të Regjistrin të Përbashkët të Transparencës kompetencë shtesë për të zhvilluar kontrolle dhe hetime si dhe obligon të tre institucionet evropiane të sigurojnë resurse të mjaftueshme për Sekretariatit.

Në takimin e 8-të negociues ndër-institucional për Regjistrin e Transparencës të mbajtur në 15 Dhjetor 2020, Parlamenti, Këshilli dhe Komisioni Evropian arritën një marrëveshje përfundimtare politike. Raporti që miraton marrëveshjen politike midis tre institucioneve u votua në seancën plenare të 27 Prillit 2021.⁹

7 <https://lobbyeurope.org/rules-and-regulations/>

8 <https://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//TEXT+TA+P6-TA-2008-0197+0+DOC+XML+V0//EN>

9 <https://www.europarl.europa.eu/legislative-train/theme-union-of-democratic-change/file-inter-institutional-agreement-on-a-mandatory-transparency-register-for-lobbyists>





RREGULLIMI I LOBIMIT NË DISA SHTETE ANËTARE TË BE-SË

1 AUSTRIA

Në Shtator të vitit 2011 u themelua Shoqata Austriake për Punë Publike (*ang. the Austrian Public Affairs Association*). Ligji Federal Austriak për Transparencën e Aktiviteteve të Lobimit dhe Përfaqësimin e Interesave Politike dhe Ekonomike hyri në fuqi më 1 Janar 2013. Kompanitë e lobimit, bizneset që punësojnë lobistë për të përfaqësuar interesat e tyre, lobistët individualë dhe shoqatat që përfaqësojnë interesat politike dhe ekonomike duhet të regjistrohen në Regjistrin zyrtar të lobimit dhe transparencës pranë Ministrisë Federale të Drejtësisë të Austrisë - një databazë publike. Ata që përfshihen në lobim duhet të respektojnë kodin e sjelljes dhe duhet ta publikojnë këtë kod në faqet e tyre të internetit. Shkelja e kodit rezultoi me ndëshkime financiare deri në 60,000 EUR dhe mund të çojë edhe në largim nga Regjistri i lobit. Kur shkelja e rregullave konsiderohet serioze, ri-regjistrimi është i mundur vetëm pas tre vjetësh.

2 BELGIKA

Në vitin 2018 u prezantua korniza e parë ligjore për një regjistër lobesh. Duke u regjistruar, lobistët dakordohen për respektim të Kodit të Sjelljes i cili do t'i bashkangjitet Rregullores së Punës së Parlamentit. Në përgjithësi, Regjistri respektohet nga të gjitha organizatat të cilat synojnë të ndikojnë në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes, por përjashtohen aktivitetet të caktuara në lidhje me ofrimin e këshillave ligjore apo këshillave të tjera profesionale.

3 FRANCA

Asambleja Franceze ka rregulluar 'përfaqësimin e interesave' në 2009, duke vendosur që Byroja e Asamblesë Kombëtare (Kreu i Administratës) të hartojë një listë të përfaqësuesve të interesit publik ose privat të cilëve më pas do t'u jepen të drejta të veçanta të hyrjes në këmbim të informatave rreth aktiviteteve të tyre dhe interesave që ata mbrojnë, ndërsa angazhohen më tej për





t'iu përmbajtur kodit të mirësjelljes të miratuar nga Byroja. Senati Francez gjithashtu miratoi rregulla të ngjashme në vitin 2009.

Një Regjistër i detyrueshëm i aprovuar me Ligjin e vitit 2016 menaxhohet nga **Autoriteti i Lartë për Transparencën e Jetës Publike** (*frenjisht Haute Autorite pour la Transparence de la Vie Publique - HATVP*) dhe ndëshkimet shkojnë deri në një vit burgim dhe gjobë prej 15,000€. Përfaqësuesit e interesave duhet të regjistrohen në Regjistër për t'u takuar me ministrat dhe kabinetin e tyre, deputetët dhe bashkëpunëtorët e tyre, zyrtarë të lartë të dhe përfaqësues të zgjedhur lokalë.

4 IRLANDA

Qysh në vitin 2003, Instituti i Irlandës për Marrëdhënie me Publikun miratoi një kod të mirësjelljes për praktikuesit profesionistë të çështjeve publike, të cilit duhet t'i përmbahen anëtarët e tij. Akti i Lobimit u miratua në vitin 2015 dhe ky akt juridik krijoi një Regjistër publik për lobistët, kurse **Komisioni i Standardeve të Institucioneve Publike** ngarkohet me detyrën e mbikëqyrjes së zbatimit të Regjistrit, monitorimin e pajtueshmërisë, ofrimin e udhëzimeve dhe ndihmës dhe, në rastet kur ishte e e nevojshme, hetimin e shkeljeve të kërkesave ligjore, sanksionimin apo edhe iniciimin e procedurave gjyqësore.

5 ITALIA

Në Mars 2017 Regjistri i parë zyrtar për lobistët u krijua në nivel kombëtar në Itali, pas shumë vitesh debate pa rregullim sistematik të lobimit. Në të vërtetë, **në periudhën midis viteve 1984 dhe 2014 një numër prej më shumë se 50 projektligjes të ndërlidhura me 'grupet e interesit' u propozuan në Itali**. Rregullorja e miratuar në

2017 vlente vetëm për Parlamentin e Italisë, duke lënë jashtë Senatin, megjithëse, si Senati ashtu edhe Dhoma e Deputetëve kishin rregulla që i lejojnë ata të kontrollojnë përfaqësuesit e organizatave publike dhe private për të marrë informacione ose dokumente të rëndësishme për aktivitetet parlamentare, si mekanizëm i përdorur nga grupet e interesit për të shprehur nevojat e tyre dhe për të dhënë kontributin e tyre te ligjvënësi.

6 LITUANIA

Versioni i fundit i ligjit për lobim hyri në fuqi në vitin 2015 dhe kërkon që të gjithë lobistët të regjistrohen në një Regjistër publik, duke paguar një tarifë, dhe duke i detyruar që të jenë në përputhje me kërkesat për transparencë rreth të ardhurave dhe shpenzimeve që lidhen me lobimin si dhe interesat e tyre në lidhje me propozimet legjislative. Edhe pse lobimi përcaktohet si një veprim i kryer me qëllim që të ndikojë në ndryshimin ose shfuqizimin e legjislacionit ekzistues ose miratimin ose refuzimin e legjislacionit të ri, **ligji nuk zbatohet për shoqata dhe OJQ**. Për më tepër, të gjithë lobistët e regjistruar janë të lidhur me Kodin e Etikës i përgatitur dhe miratuar nga **Komisioni i Etikës**. Ky Komision mbikëqyr pajtueshmërinë me standardet institucionale të etikës, rregullon interesat publike dhe private në institucionet publike dhe kontrollon disa aktivitete lobuese.

Në vitin 2015, projektligji i ri për lobimin u dorëzua në Parlamentin Lituanëz. Sipas tij, të gjithë lobistët, përfshirë edhe OJQ-të, detyrohen të regjistrohen në Komisionin Kryesor të Etikës dhe të raportojnë çdo aktivitet lobist. Në qershor të vitit 2020, Seimas (parlamenti lituanëz) miratoi ligjin e ri pas një skandali që përfshiu shoqatën bankare të vendit dhe konfederatën e biznesit. Ligji përfshin edhe të ashtuquajturën deklaram të





kryqëzuar (*ang. cross-declaration*) që kërkon që si lobistët ashtu edhe politikanët dhe nëpunësit publikë të raportojnë kontaktet e tyre.

7 HOLANDË

Një Regjistër lobuesish u prezantua në korrik të vitit 2012 por është i zbatueshëm vetëm për Dhomën e Përfaqësuesve, edhepse lobistët e regjistruar në Dhomë kanë qasje edhe në ndërtesat e Senatit. Në fakt, regjistrimi është i detyrueshëm vetëm për të hyrë fizikisht në 'zonat e sigurta' të ndërtesës së Parlamentit. Shoqata Profesionale Holandeze e Lobistëve (Beroepsvereniging van Public Affairs - BVPA) - u themelua në vitin 1999 dhe prezantoi një Kod të Sjelljes për të vetë-rregulluar anëtarët e saj. Duke u anëtarësuar, lobistët pranojnë të respektojnë Kodin të cilin, nëse nuk e respektojnë, mund të përjashtohen nga Shoqata.

8 POLONIA

Shoqata e Lobistëve Profesionistë në Poloni (APLP) u krijua në vitin 2003 dhe miratoi një Kod të Etikës në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare. APLP ishte shumë aktive gjatë diskutimeve parlamentare që çuan në miratimin e ligjit të Polonisë për lobimin i prezantuar në vitin 2005. Ky ligj zbatohet vetëm për aktivitetet e lobistëve profesionistë dhe kërkon që secila palë e interesuar që dëshiron të japë mendimin e saj gjatë procesit legjislativ duhet të plotësojë një pyetësor të veçantë, të regjistrohet në Ministrinë e Administratës dhe Digjitalizimit dhe të paraqes Certifikatën e Regjistrimit sa herë që kontakton një politikan apo përfaqësues të administratës publike. Edhe zyrtarët publikë duhet të raportojnë sa herë që kontaktojnë me lobistë profesionistë. Mosregjistrimi si një entitet lobues rezulton në gjoba prej 750 € dhe 12,500 €. Ligji zbatohet

vetëm për lobistët profesionistë dhe përjashton të gjitha kategoritë e tjera të personave fizikë ose juridikë siç janë përfaqësuesit e organizatave ose shoqatave. Aktualisht po zhvillohet debat i gjerë rreth ndryshimit të ligjit sepse "kërkesat e tepërta për raportim po inkurajojnë zyrtarët të mbajnë kontakte "të heshtura" me lobistët e regjistruar".

9 MBRETËRIA E BASHKUAR

Mbretëria e Bashkuar është një nga vendet e para në Evropë ku lobimi njihet si si titull zyrtar për aktivitetet profesionale dhe me lobistët e parë profesionistë parlamentarë që u raportuan që në vitin 1913. Në ndërkohë u krijuan një numër organizatash për të provuar krijimin e regjistrave ose kodet e mirësjelljes për lobistët, të cilat përfundimisht u centralizuan dhe tani janë kryesisht nën maskën e Charter Institute of Public Relation (CIPR)¹⁰. Për shkak të karakterit jo-detyrues të këtyre mekanizmave vetë-rregullues, Parlamenti miratoi Ligjin për Transparencën e Lobimit, Fushatën jo-partiake dhe Administrimin e Organizatave Sindikale¹¹ në 2014. Procedurat zyrtare u mundësojnë individëve të llobojnë te deputeti i tyre, por shumica e aktiviteve lobuese janë të përqëndruara te korporatat, shoqatat e bamirësisë dhe atyre tregtare.

10 SLLOVENIA

Aktiviteti i lobimit përfshihet në Ligjin për Integritetin dhe Parandalimin e Korrupsionit të vitit 2010. Sipas tij, lobim quhet çdo kontakt jo-publik i një lobisti me persona të lobuar që ka për qëllim të ndikojë në përmbajtjen ose procedurën në lidhje me miratimin e vendimeve të përmendura më

¹⁰ <https://www.cipr.co.uk/>

¹¹ <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2014/4/contents/enacted>





lant. Lobistët duhet të regjistrohen në një Bazë të Dhënash Publike nën mbikëqyrjen e Komisionit Anti-Korrupsion, si organ i pavarur shtetëror me një mandat në fushën e parandalimit dhe hetimit e korrupsionit, shkeljet e etikës dhe integritetin e funksioneve publik. Në rastin e Sllovenisë, rregullimi i aktiviteteve të lobimit gjithashtu inkurajoi formimin e Shoqatës Sllovene të Lobistëve në vitin 2010 dhe Kodin e Etikës i detyrueshëm për të gjithë anëtarët.

11 SKOCIA

Projektligji për lobim u prezantua para Parlamentit Skocez në vitin 2015 dhe u miratua një vit më pas. Ligji rregullon krijimin e një Regjistri ku ruhen informacionet në lidhje me lobimin nga konsulentë të paguar dhe lobistë të brendshëm të cilët merren drejtpërdrejt me zyrtarë publikë. Regjistri administrohet nga nëpunësi i Parlamentit i cili ka kompetenca të kërkojë informata dhe të monitorojë pajtueshmërinë me ligjin. Ligji rregullon edhe sanksionet penale për ata që nuk sigurojnë informacionin e kërkuar dhe mandaton Parlamentin të hartojë Kodin e Sjelljes.

12 GJERMANIA

Qysh në vitin 1972 Bundestag-u gjerman miratoi rregulla specifike në lidhje me përfaqësimin e interesave duke krijuar një listë të shoqatave që kishin të drejtë të merren parasysh nga pushteti legjislativ dhe të rregullojnë hyrjen e tyre në Parlament. Përveç kësaj, sipas Aneksit 2 të Rregullores së Punës së Bundestag-ut, hartohet dhe publikohet një listë publike vjetore e të gjitha grupeve që dëshirojnë të shprehin ose mbrojnë interesat para Bundestag-ut apo Qeverisë Federale. Lista e subjekteve është në dispozicion publikisht, por ato nuk janë të lidhura me ndonjë

Kod specifik të Sjelljes. Regjistrimi është vullnetar, por në parim, lobistët nuk mund të dëgohen nga një komision parlamentar nëse nuk janë regjistruar (edhe pse Komisionet dhe Bundestagu mund të ftojnë lirish shoqata dhe ekspertë që nuk janë në listë).

13 BULLGARIA

Rregullore dhe legjisllacioni i posaçëm janë miratuar për çështje si qasja në informacion, financimi i partive politike dhe ligjet e parandalimit të konfliktit të interesave, si dhe kriminalizimi i ushtrimit të ndikimit, edhe pse duket hasin në vështirësi gjatë zbatimit. Debatet rreth krijimit të një Regjistri po vazhdojnë të paktën që nga viti 1999 kur u hartua projektligji i parë mbi këtë temë. Në vitin 2002, projektligji i parë që propozonte krijimin e një Regjistri për lobistët, i ndjekur nga një seri propozimesh tjera në periudhën midis 2006 dhe 2008, nuk u miratuan kurrë.

14 KROACIA

Që nga viti 2008 diskutimi publik rreth lobimit është intensifikuar në Kroaci. Në të njëjtin vit, u themelua Shoqëria Kroate e Lobistëve (HDL) që synon të promovojë dhe të rrisë ndërgjegjësimin në lidhje me rëndësinë e rregullimit të lobimit. Deri më sot, HDL është burimi i vetëm i të dhënave për 'lobistët e regjistruar'. Kur hyn në HDL, secili anëtar duhet të nënshkruajë Kodin Etik të HDL, i cili kërkon nga ata të respektojnë sjelljet në përputhje me dispozitat e tij. Përkundër punës së HDL, asnjëherë nuk u prezantua një ligj zyrtar me qëllim të rregullimit të aktiviteteve të lobimit, edhe pse përmendja e futjes së një ligji të tillë është bërë në Planin e Veprimit Antikorruption për 2014-2020 që Qeveria Kroate i ka dërguar Komisionit Evropian.



15 REPUBLIKA ÇEKE

Shoqata Çeke e Agjencive të Çështjeve Publike (APAA) e krijuar në 2012 ka miratuar një Kod të Sjelljes, të cilit profesionistët e Lobimit mund t'i përmbahen kur regjistrohen vullnetarisht në shoqatë. APAA shërben gjithashtu si një organ këshillimor në procesin e përgatitjes së skemës rregullatore të lobimit në Republikën Çeke. Në 2005 u formulua propozimi i parë i cili përmendi nevojën për një regjistër parlamentar. Në periudhën midis 2005-2013, kishte propozime të mëtejshme rreth 'Aktit të Lobimit' i cili kurrë nuk u miratua.

Në fund të vitit 2017, komiteti anti-korrupsion i qeverisë Çeke më në fund prezantoi propozimin e tij material për Aktin e Lobimit. Pikërisht përpara zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2018, qeveria çeke miratoi një propozim për Aktin e Lobimit. Propozimi ishte rezultat i përpjekjeve afatgjata të qeverisë së mëparshme për të hequr ndikimin e padëshiruar dhe korrupsionin nga procesi legjislativ. Komiteti anti-korrupsion, i krijuar nga qeveria Çeke si organi i tij këshillues, ka hartuar mënyra të ndryshme për t'iu qasur çështjes që, nëse miratohet, mund të ndryshojë mënyrën e kryerjes së lobimit në Republikën Çeke.

Legjislati i planifikuar përfshin propozime të tilla si regjistrimi i detyrueshëm i lobistëve profesionistë, mirëmbajtja e një kalendari publik të dizajnuar për të treguar se kush po takon kë në një kohë të caktuar dhe ndryshime në Ligjin e Konfliktit të Interesit, të tilla si kufizime të rritura në lidhje me dhuratat dhe kërkesat për zbulimin e të ardhurave për zyrtaret qeveritare. Akti i propozuar gjithashtu planifikon të parashikojë stimuj që duhet ta bëjnë regjistrimin më tërheqës, nxitja kryesore e shënimit është leja për të hyrë në mjediset parlamentare. Megjithatë, nuk është ende e qartë nëse lobistët e regjistruar do të kenë qasje në kantinën e famshme parlamentare.

Krahasimi i kornizave ligjore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian zbulon tipe të ndryshme të sistemeve që mund të klasifikohen teorikisht dhe mund të vlerësohet efektiviteti i tyre. Bazuar në një skemë klasifikimi të zhvilluar nga Qendra për Integritet Publik¹², rezultatet i janë caktuar secilit shtet me legjislacionin e lobimit, bazuar në një sondazh në lidhje me tetë fusha kryesore të hulumtimit për lobistët:

- 1 definicioni për lobistin,
- 2 regjistrimi individual,
- 3 shpalosja e shpenzimeve individuale
- 4 shpalosja e shpenzimeve të punëdhënësit,
- 5 regjistrimi elektronik,
- 6 futja e qytetarit në regjistër të lobistëve,
- 7 autoriteti për zbatimin e ligjit
- 8 dispozitat rreth *dyerve rrotulluese* (me një fokus të veçantë në "periudhën e ftohjes").

Në bazë të rezultateve mund të dallohen tre lloje të gjera të kategorive të sistemeve rregullatore të lobimit:

- 1 sisteme me rregullim të ulët,
- 2 sisteme mesatarisht të rregulluara dhe
- 3 sisteme shumë të rregulluara.

Shtetet evropiane kanë ndërtuar kryesisht sisteme "të buta" dhe mesatarisht të rregulluara, ndërsa sisteme të larta rregulluese mund të gjenden në Amerikën Veriore (Shtetet e Bashkuara dhe Kanada). Tabela në vijim paraqet një përmbledhje të karakteristikave të përgjithshme të tre llojeve të rregullimit ligjor si dhe përparësitë e mangësitë e tyre:

12

<https://publicintegrity.org/>



	Sistemi me rregullim "të butë"	Sistemi mesatarisht i rregulluar	Sistemi shumë i rregulluar
<p>Disa shtete dhe Institucione</p>	<p>Gjermania, Parlamenti Evropian, Franca dhe Polonia</p>	<p>Lituania, Hungaria, Kanadaja, Disa shtete federale të SHBA-së</p>	<p>SHBA</p>
<p>Karakteristikat e përgjithshme</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullat për regjistrim individual ekzistojnë, por gjatë këtij procesi kërkohen pak detaje (në rastin e Palamentit Evropian lobistët nuk janë të obliguar të deklarojnë se për cilën çështje, për kë dhe në cilin institucion llobojnë). - Korniza ligjore njih vetëm lobistët në organin legjislativ dhe përkufizimi nuk përfshin edhe lobistët në degën ekzekutive të pushtetit. - Nuk ka rregulla për publikimin e shpenzimeve individuale (nga lobisti nuk kërkohet të paraqesë një raport shpenzimesh) ose për shpalosjen e shpenzimeve të punëdhënësit (punëdhënësi i një lobisti nuk është i detyruar të paraqesë raport shpenzimesh). - Ekziston një sistem i dobët për regjistrimin online dhe listat e lobistëve janë në dispozicion të publikut, por jo të detajizuara (siç janë raportet e shpenzimeve nga lobistët). - Autoritetet kompetente për zbatimin e rregullave për lobim kanë pak pushtet dhe në disa vende nuk garantohet autonomia e tyre e plotë. - "Periudha e ftohjes" nuk parashihet në kornizën ligjore, që do të thotë se ligjvënësit/nëpunësit mund të regjistrohen si lobistë me të përfunduar të mandatit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullat për regjistrimin individual ekzistojnë dhe janë më të rrepta sesa të sistemet me rregullim të butë. - Entiteti i regjistruar duhet të deklarojë çështjen, përfituesin e lobimit dhe institucionin qeveritar ku synohet të llobohet. - Përveç lobistëve legjislativë, përkufizimi i lobistit njih edhe lobistët e degës ekzekutive. Te disa shtete ekzistojnë dispozitat që lidhen me shpalosjen individuale të shpenzimeve. - Nuk e rregullon raportimin e shpenzimeve të punëdhënësit të lobuesit. - Posedon sistem të fuqishëm për regjistrim <i>online</i>. Qasja e publikut në Regjistër është e lehtë dhe përditësohet në intervale shumë të shpeshta, megjithëse detajet rreth shpenzimeve nuk janë në domenin publik. - Një Agjenci shtetërore kryen rishikime dhe auditime të obligueshme megjithëse rrallë do të ndjekë penalisht shkelësit e Rregullores, duke pasur parasysh mungesën e burimeve dhe informacionit. - Sistemi parasheh një periudhë ftohjeje pasi ligjvënësit të kenë mbaruar mandatit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Karakteristikë e këtij lloji të sistemit janë rregulla strikte për regjistrim individual (për shembull, jo vetëm që kërkohet fusha dhe institucioni gjatë regjistrimit, por edhe emrat e të gjithë punonjësve dhe raportimi pothuajse i menjëhershëm i çdo ndryshimi në regjistrim). Ngjashëm me sistemet mesatarisht të rregulluara, përkufizimi i lobistit njih lobistët e degës ekzekutive. - Këto sisteme e bëjnë obligative shpalosjen individuale të shpenzimeve, për dallim nga dy llojet tjera të sistemeve. - Ekziston Sistemi për Regjistrim Online dhe publiku ka qasje në Regjistrin e Llobimit i cili përditësohet në intervale të shpeshta, përfshirë edhe sektorin e shpalosjes së shpenzimeve, që është publike (e veçantë e sistemit amerikan të lobimit). - Agjencitë shtetërore kryejnë rishikime dhe auditime të detyrueshme dhe ekzistojnë sanksione ligjore për dorëzimin me vonesë dhe jo të plotë të formularit të regjistrimit të lobimit. - Sistemi parasheh një periudhë ftohjeje pasi ligjvënësit të kenë mbaruar mandatit.





	Sistemi me rregullim "të butë"	Sistemi mesatarisht i rregulluar	Sistemi shumë i rregulluar
<p>Përparësitë</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Sistemi me rregullim të butë ligjor parashikon një standard minimal të regjistrimit për lobistët. - Për më tepër, kërkesat burokratike për lobistët është relativisht e lehtë. Mirëmbajtja e Regjistrimit dhe lëshimi i lejeve për qasje në institucionet politike nuk janë të rënda as për institucionet. - Në përgjithësi, kostoja për vendosjen dhe mirëmbajtjen e një sistemi të tillë janë relativisht të ulëta. 	<ul style="list-style-type: none"> - Përparësitë kryesore të sistemeve të rregullimit të mesëm janë se ata i sigurojnë publikut qasje në një regjistër të lobistëve dhe atyre që llobohen, duke u kërkuar lobistëve të japin informacione se në cilin institucion po llobojnë, tek cili ligjvënës, zyrtar i ekzekutivit apo zyrtar publik. - Regjistri qendror siguron më shumë informacione krahasuar me sistemet me rregullim të butë. - Regjistrimi në Internet, kërkon pak përpjekje për t'u përdorur dhe përditësuar, pa kosto të larta mirëmbajtjeje. - Disa shtete në këtë grup kanë edhe zyra me më pak se 5 zyrtarë që rrit koston financiare megjithëse janë më të ulëta sesa kostoja e sistemeve me rregullim të lartë. 	<ul style="list-style-type: none"> - Ky sistem ofron zgjidhjen më gjithëpërfshirëse për të siguruar që lobistët nuk mund të ndikojnë padrejtësisht në përfaqësuesit e zgjedhur ose zyrtarët publikë. - Për më tepër, kërkesa për të zbuluar detaje të plota në të gjitha aspektet, veçanërisht publikimet e detyrueshme të shpenzimeve, si dhe auditimet nga agjencione rregullatore të pavarura dhe imune nga ndërhyrjet e qeverisë, kufizon më tej mundësinë e lobuesve për t'u përfshirë në veprime të paligjshme.
<p>Mangësitë</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Mangësi e sistemit me rregullim të ulët është se ajo nuk i ofron informatë të plotë publikut rreth ndikimit që lobistët kanë në politikë. - Lobistët nuk janë të obliguar të deklarojnë se për kë llobojnë dhe për çështjen që llobojnë. - Në përputhje me rrethanat, si transparenca ashtu edhe llogaridhënia ka më pak të ngjarë të sigurohen në sistemet me rregullim të butë në krahasim me sistemet me rregullim të mesëm dhe të lartë. - Gjithsesi qytetarët kanë më shumë informata në dispozicion rreth aktiviteteteve politike të lobistëve sesa në sistemet që nuk kanë fare ligj për lobim. 	<ul style="list-style-type: none"> - Mangësitë e rregullimit të mesëm konsistojnë në atë se nuk kërkojnë nga lobistët që të deklarojnë detaje të plota për punëdhënësit e tyre. Gjithashtu, shpalosjet e plota të shpenzimeve nuk janë në domenin publik. Në këtë kontekst, gjersa publiku mund të mësojë se kush është lobisti, ku ka lobuar dhe për çfarë çështje po lobon, nuk arrin të fitojë një pasqyrë të plotë të aktivitetit lobist. - Te sistemet me rregullim të mesëm është karakteristike dukuria e ofrimit të këshillave profesionale "falas" për partitë politike nga lobistët për shkak të boshllëqeve ligjore në sistem. 	<ul style="list-style-type: none"> - Duke aplikuar një rregullim të tillë gjithëpërfshirës disa e konsiderojnë "barrë burokratike" për lobistët të cilët duhet të paraqesin dhe përditësojnë rregullisht profilin e tyre. Qeveritë mund të akuzohen se po pengojnë qëllimshëm këto aktivitete. - Ndërtimi i një sistemi të tillë vjen me kosto relativisht të lartë financiare krahasuar me llojet e tjera të sistemeve.

Tabela 1. Karakteristika e përgjithshme të tre llojeve të rregullimit ligjor, përparësitë dhe mangësitë e tyre





PRAKTIKAT E SHTETEVE FQINJE

Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi kanë hartuar ligje për lobim, pavarësisht se një gjë e tillë nuk ka qenë kusht për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE. Në Maqedoni dhe Serbi lobist konsiderohet secili person fizik i regjistruar në Regjistrin e Lobistit. Ndërsa në Mal të Zi, lobist mund të jetë një person fizik, kompani lobimi apo organizatë e shoqërisë civile.

Në rastin e Serbisë dhe Malit të Zi, opinionet mbi ligjet, rregulloret ose projektligjet, rregulloret e tjera dhe aktet e përgjithshme që publikohen në media nuk konsiderohen si aktivitete lobiste. Po ashtu edhe aktivitetet e personave që e bëjnë pozicionin e tyre publik ose paraqesin propozime dhe mendime ekspertësh tek autoritetet me qëllim që të japim mendimin e tyre për ligjin apo rregulloret dhe iniciativat qytetare drejtuar autoriteteve në lidhje me zgjidhjet e propozuara në ligje apo rregullore. Në rastin e Maqedonisë aktivitetet e thirrura për të marrë pjesë në procesin e përgatitjes së ligjeve dhe rregulloreve të tjera nga legjislativi, ekzekutivi ose pushteti lokal nuk konsiderohen si aktivitete lobuese, pavarësisht nga fakti nëse ata kryejnë veprimtari me ose pa kompensim. Për më tepër pjesëmarrja e personave juridik (agjencitë, institucionet, OJQ-ët të cilat kanë fushëveprimtari të ndryshme) në aktivitetet e cekura më lartë, nuk do të konsiderohet si aktivitete lobiste.

Në Mal të Zi dhe Serbi është përcaktuar me ligj që personi tek i cili mund të lobohet duhet të jetë një

person i zgjedhur, i nominuar, i emëruar që merr pjesë në procesin e përgatitjes dhe miratimit të një ligji. Ndërsa në ligjin për lobim në Maqedoni nuk është përcaktuar se kush duhet të jetë personi tek i cili mund të lobohet. Parimisht, lobistët duhet të lobojnë tek personat të cilët përfaqësojnë interesin publik.

Për t'u regjistruar, lobuesit duhet të përmbushin disa kriteret të parapara me ligj si: posedimi i diplomës universitare, dëshmia e zotësisë së plotë juridike për të vepruar si dhe të mos jetë i dënua për ndonjë vepër penale. Përderisa Maqedonia e Veriut kërkon që personi lobues të jetë shtetas i tyre; në Mal të Zi lobuesi mund të jetë edhe qytetar i ndonjë shteti tjetër me kusht që është regjistruar në Regjistrin për lobim. Nga ana tjetër, në Serbi një person i huaj fizik mund ushrojë aktivitet lobimi vetëm nëse është i regjistruar ose kryen lobim në shtetin e të cilit ka shtetësinë dhe nëse është regjistruar në një regjistër të veçantë të personave fizikë të huaj që kryejnë lobim në territorin e Serbisë.


Të tri shtetet ballkanike e kanë të paraparë me ligj se çfarë duhet të përmbajë Regjistri dhe si duhet të bëhet mbikëqyrja. Në rastin e Maqedonisë, Ministria e Drejtësisë duhet të përcaktojë formën dhe përmbajtjen se çfarë duhet të ofrojnë lobuesit për tu regjistruar në Regjistër, si dhe procedurat e mirëmbajtjes së Regjistrit. Ndërsa Sekretari i Parlamentit të Maqedonisë është përgjegjës për mirëmbajtjen e Regjistrit. Lobistët e regjistruar kanë për obligim që të dorëzojnë raportin për punën e tyre tek Sekretari i Kuvendit apo tek





Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, jo më vonë se më 31 janar. Në raport duhet të përfshihen të dhënat si: dëshmitë që është i regjistruar si lobues, çështja e lobimit, aktivitetet lobuese, të dhënat financiare që ka përfituar nga lobimi. Në rast të mospërbushjes së kërkesave të nevojshme të parapara me ligj, lobistët mund të largohen nga Regjistri me kërkesën e Komisionit drejtuar Sekretarit të Kuvendit. Sekretari duhet të verpojë sipas kërkesës së Komisionit.

Në Serbi dhe Mal të Zi autorizimi për zhvillimin e aktiviteteve lobiste lëshohet nga Agjencioni për Parandalimin e Korrupsionit në afat kohor prej tre vitesh me mundësi zgjatjeje. Agjencioni po ashtu është përgjegjëse për të mirëmbajtjen e Regjistrit të lobuesve. Lobuesit bëhet pjesë e Regjistrit në datën që marrin autorizimin nga Agjencioni. Menjëherë pasi që të merret vendimi për regjistrimin Agjencioni fut të dhënat në Regjistër. Agjencioni po ashtu është përgjegjës për mirëmbajtja dhe mbikëqyrja e Regjistrit. Sikurse në rastin e Maqedonisë, edhe në Serbi dhe Mal të Zi, lobistët duhet të dërgojnë raportin me shkrim Agjencisë rreth aktiviteteve të dyre deri më 31 janar të vitit aktual për vitin paraprak. Për më tepër në rastin e Serbisë dhe Malit të Zi janë paraparë ndëshkime monetare për lobuesit në rast se dështojnë të njoftojë Agjencinë për çdo ndryshim të të dhënave të Regjistrit, fillon procedurën e lobimit para se të lidh ndonjë kontratë lobimi, dështon të paraqesë një raport me shkrim të aktiviteteve në Agjenci dhe në kohën e paraparë me ligj.



Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi kanë hartuar ligje për lobim, pavarësisht se një gjë e tillë nuk ka qenë kusht për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE.
Në Maqedoni dhe Serbi lobist konsiderohet secili person fizik i regjistruar në Regjistrin e Lobistit. Ndërsa në Mal të Zi, lobist mund të jetë një person fizik, kompani lobimi apo organizatë e shoqërisë civile.





REKOMANDIMET

- 1** Nuk ka qenë synim i këtij studimi për të vlerësuar se cili prej sistemeve rregullative është më i përshtatshëm për Kosovën. Ky është vendim që duhet ta marrin aktorët politikë duke tentuar të përgjigjen pyetjeve se cilat janë qëllimet dhe objektivat kryesore që synohen të arrihen duke miratuar legjislacionin për lobim dhe cilat janë implikimet buxhetore të ligjit që do të ishin të përballueshme për kuletën e shtetit. Cilido qoftë modaliteti i zgjedhur, korniza ligjore për lobim do të duhej:
- 2** Të definojë qartë lobimin, llojet e aktiviteteve që konsiderohen legjitime, qëllimet e pranueshme të një aktiviteti lobues si dhe entitetet (individët apo grupet) që mund të kualifikohen si lobues.
- 3** Të parasheh qartë se cilët nga zyrtarët publikë mund të komunikojnë me lobuesit.
- 4** Të parasheh krijimin e një Regjistri për Lobues, në të cilin lobistët individualë dhe organizatat lobuese regjistrohen në mënyrë që të fitojnë të drejtën për të zhvilluar aktivitete lobiste.
- 5** Regjistrimi i lobuesve duhet të jetë i obligueshëm. Asnjë individ/ organizatë nuk mund të konsiderohet lobiste nëse nuk është regjistruar paraprakisht në Regjistër.
- 6** Entitetet e regjistruara duhet të raportojnë për aktivitetet e tyre në baza periodike (periudha duhet të përcaktohet me ligj). Këto raporte duhet të përmbajnë Informacione rreth identitetit të lobuesit, çështjes për të cilën zhvillohen aktivitetet e lobimit dhe rezultatet e synuara, përfituesin e fundit të aktiviteteve të lobimit, institucionin dhe zyrtarin publik të synuar, llojin dhe numrin e aktiviteteve të lobimit, shpenzimet e lobimit, burimet financiare etj.





- 7** Të **garantojë** transparencë gjatë komunikimit mes lobuesve dhe zyrtarëve publik në mënyrë që të sigurojë pjesmarrjen e të gjitha palëve të interesuara dhe të **kontribuojë** në rritjen e besimit të publikut.
- 8** Të ndajë përgjegjësinë për **transparencë** mes lobuesit dhe zyrtarëve publikë, duke u paraparë sanksione efektive dhe proporcionale për lobistët dhe zyrtarët publik në rast të shkeljes së rregullave të lobimit.
- 9** Të **parandalojë** futjen e menjëhershme të ish-zyrtarëve publikë në sektorin privat si lobist me të përfunduar postin publik. Kjo arrihet përmes caktimit të *periudhës së ftohjes* (nga anglishtja *cooling period*) me qëllim të parandalimit të fenomenit të **dyerve rrotulluese** (nga anglishtja *revolving door*). Periudha e ftohjes në vende të ndryshme ndryshon nga dy deri në pesë vjet.
- 10** Dispozitat për parandalimin e fenomenit të "dyerve rrotulluese" duhet të shmangin rastet e konfliktit të interesit duke parandaluar keqpërdorimin e informacioneve dhe lidhjeve të ish-politikanëve me aktorët brenda institucioneve.
- 11** Ligji duhet të parasheh saktë se cilat janë aktivitete legjitime lobiste dhe t'i dallojë ato nga iniciativat e ndryshme avokuese që vijnë nga shoqëria civile.
- 12** Ligji duhet të parasheh krijimin e një organi të pavarur i cili do të administrojë Regjistrin zyrtar të lobimit, të rishikojë konfliktet e mundshme të interesit, të hetoj ankesat për shkelje dhe parregullsi, të ofroj udhëzime dhe trajnime **për lobuesit dhe zyrtarët publikë**.



